



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.86/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me apelin e Merita Ramaj nga Gjermania, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve, për Zgjedhjet e parakohshme Parlamentare që do të mbahen me 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i pasafatshëm apeli i identifikuar me numër: Anr.86/2019, i datës 24.09.2019, i paraqitur nga Merita Ramaj nga Gjermania, me të cilin ka kërkuar që të përfshihet në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 24.09.2019 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Merita Ramaj, në të cilën me të cilën pretendon se i është mohuar e drejta për të votuar pasi që të njëjtës iu është refuzuar kërkesa për tu përfshirë në listën e votueseve jashtë Kosovës. Në apel apeluësja kërkon që ti mundësohet plotësimi i dokumentacionit me qëllim që ajo të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës. Në mbështetje të apelit ka bashkangjitur apelin formularin për aplikim si votuese jashtë Kosovës si dhe dokument identifikimin-letërnjoftimin të shtetit Gjerman.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm

Paneli, pas shqyrtimit të apelit, ka gjetur se apeli i paraqitur nga Merita Ramaj kundër vendimit të KQZ-së, është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 122 paragraf 1 të LZP-së, me të cilën përcaktohet se: *“Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP, brenda (24) orëve”*. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i

shkresave të lëndës rezultoi se periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, ka filluar nga data 30.08.2019 dhe ka përfunduar me datën 10.09.2019. Vendimi i KQZ-së, për Certifikimin e Listës së Votuesve, është publikuar me datën 19.09.2019, ndërsa afati për apel ka qenë njëzetekatër (24) orë nga momenti i publikimit të vendimit të KQZ-së. Apeli në PZAP, është paraqitur nga apeluesi me datë 24.09.2019, që do të thotë se apeluesi apelin e ka parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 122 par.1 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë në kuptim të nenit 115 paragraf 1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 86/2019 me datën 25.09.2019

**Kryesuesi i Panelit
Gyltëne Sylejmani**



***Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*